

UDHËZIM
Nr.7, datë 10.1.2012

Dt.Miratimit:10.01.2012, Flet.Zyrtare Nr.2, Faqe:53

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TË PROCESVERBALEVE, QË DO TË PLOTËSOHEN NGA PËRFAQËSUES TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË BASHKIVE/NJËSIVE BASHKIAKE/KOMUNAVE, PËR RASTET E FËMIJËVE TË GJETUR DHE TË FËMIJËVE TË PAREGJISTRUAR NË GJENDJEN CIVILE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pikës 1, 2, 3 të nenit 40, pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, të cilët duhet të përcaktohen më parë nga titullari përkatës, kur konstatojnë sipas rastit:

a) fëmijë, të cilët janë të pajisur me "certifikatën e asistencës në lindje"/"procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes", por që për shkaqe të ndryshme nuk janë të regjistruar dhe nënat e tyre i kanë lënë nën kujdesin e të afërmeve;

b) fëmijë të lindur dhe të pajisur me dokumentacion, por që nuk janë regjistruar në kohë për arsye subjektive;

c) fëmijë të gjetur, të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacion, "certifikatën e asistencës në lindje"/"procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes"; duhet të hartojnë menjëherë procesverbalin dhe të ndjekin regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile, nën juridiksionin territorial të së cilës është gjetur/deklaruar si i paregjistruar fëmija.

2. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit që kanë gjetur/konstatuar rastin, bëjnë dokumentimin e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1/a., b., c., duke plotësuar përkatësisht formularin tip Mod.1/Mod.2 Mod.3 në tri kopje.

3. Secili përfaqësues krijon dosjen përkatëse, në të cilën përfshihen:

- kopja e procesverbalit;

- asistenca e lindjes, apo çdo dokument që mund të disponojë i interesuari sipas rastit;

- foto të çastit të gjetjes së fëmijës.

4. Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, si dhe pala e interesuar nëse ka, së bashku me fëmijën, paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile për të bërë deklarimin e lindjes së fëmijës pas plotësimit të praktikave, sipas përcaktimeve në pikën 1:

a) për rastin e përcaktuar në pikën 1.a., do të plotësohet procesverbali Mod.1, të cilit i bashkëlidhet "certifikata e asistencës në lindje"/"procesverbali i hartuar në kohën e lindjes", që disponojnë të afërmit e fëmijës;

b) për rastin e përcaktuar në pikën 1.b., do të plotësohet procesverbali Mod.2., të cilit i bashkëlidhet "certifikata e asistencës në lindje";

c) për rastin e përcaktuar në pikën 1.c të këtij udhëzimi, do të plotësohet procesverbali Mod.3., të cilit i bashkëlidhet "raporti mjekësor", i plotësuar nga mjeku i zonës ku është gjetur fëmija.

5. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile zbaton rast pas rasti të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", për këto kategori fëmijësh dhe për çdo akt të mbajtur njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetarët e bashkive/njësive bashkiake/komunave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

7. Ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM

Bujar Nishani

Mod.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME
PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.a)

I mbajtur sot, më datë . . . , nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njesisë bashkiake/komunës , rrethi nga;

1.Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati ;

2.Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës ;

N ë prani të:

Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(numri personal)

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është

dhe se fëmija ka lindur në

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj.)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 dhe 7

të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", mbahet ky

procesverbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës, faktin e lindjes së të cilit,

deklaruesi e vërteton me dokumentin "asistencë lindje", që i bashkëlidhet këtij

procesverballi.

Shënim. Pas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas nenit 39 (pika 1, 2, 3,

5) të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile" dhe pajisjes së tij me

certifikatë lindjeje, personi i interesuar duhet t'i drejtohet gjykatës për marrjen e

kujdestarisë së fëmijës/ose për njohjen e atësisë/amësisë.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë
bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër) (emër, atësi, mbiemër)

(nënshkrimi) (nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër) (nënshkrimi)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.b)

I mbajtur sot, më datë . . . , nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njesisë bashkiake/komunës , rrethi nga;

1. Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati ;

2. Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës ;

në prani të,

Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(numri personal) i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është

dhe se fëmija ka lindur në

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj.)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009

"Për gjendjen civile", mbahet ky procesverbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës së paregjistruar, faktin e lindjes së të cilit deklaruesi e vërteton me dokumentin "asistencë lindje", që i bashkëlidhet këtij procesverbal.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë
bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër) (emër, atësi, mbiemër)

(nënshkrimi) (nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër) (nënshkrimi)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME
PROCESVERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.c)

I mbajtur sot, më datë . . . , nën juridiksionin e territorit të
(dita, muaji, viti)

bashkisë/njesisë bashkiake/komunës , rrethi nga;

1. Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i Policisë së Shtetit, komisariati ;

2. Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

përfaqësues i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës ;

në prani të,

Z/znj. , i pajisur me dokument identifikimi ;

(emri, atësia, mbiemri) (numri personal)

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është

dhe se fëmija ka lindur në

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj.)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 të

nenit 41 të ligjit nr.10

129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", mbahet ky procesverbal për

konstatimin e fëmijës së gjetur, të

seksit , në vendin e quajtur .

Shënim. Pas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas nenit 39 (pika 1, 2, 3,

5) të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile" dhe pajisjes së tij me

certifikatë lindjeje, personi i interesuar duhet t'i drejtohet gjykatës për marrjen e

kujdestarisë së fëmijës/ose për njohjen e atësisë/amësisë.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit Përfaqësuesi i bashkisë/njesisë
bashkiake/komunës

(emër, atësi, mbiemër) (emër, atësi, mbiemër)

(nënshkrimi) (nënshkrimi)

Pala e interesuar

(emër, atësi, mbiemër) (nënshkrimi)